



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, Datë ____/____/202__

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 166,
DATË 23.12.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË
FAMILJEVE PËRFITUESE, TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË
BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR
SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN
TRUALL DHE KALIMIN NË NJË PROGRAM TJETËR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, VKM-së nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës" i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Komsioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 166, datë 23.12.2021 "Për miratimin e listës së 8 të 25 subjekteve përfituese të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model", duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese të grantit të rindërtimit të banesave individuale, për shkak të pamundësisë për të rindërtuar në të njëjtin truall të subjektit përfitues Xhemaile Deda me numër rendor 23.
2. Miratimin e subjektit përfitues, znj. Xhemaile Deda, si subjekt përfitues nga programi i zhvillimit të zonave të reja për zhvillim, sipas tabelës së mëposhtme.

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMER	MBIEMER	PERBERJA FAMILJARE	STRUKTURA	ZONA E TRANSFERIMIT
I	MANEZ	XHEMAILE	DEDA	4	2+1	MANEZ

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor

Alneida Rroshi



KOMISIONI I POSAÇËM

Kryetar

Gentian Kallmi



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I POSAÇËM**

RELACION

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 166, DATË 23.12.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE, TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN NË NJË PROGRAM TJETËR

Të nderuar këshilltarë,

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës", i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi pas vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, sipas relacionit si më poshtë vijon:

Konkretisht, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ndodhur në dosjet e subjekteve përfitues znj. Xhemaile Deda nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, rezulton se;

Këshilli Bashkiak me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 166, datë 23.12.2021 "Për miratimin e listës së tetë të 25 subjekteve përfituese të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të

banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model”, ndër të tjera ka miratuar edhe listën e subjekteve përfituese të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model, hartuar nga Komisioni i Posaçëm ku është miratuar si subjekt znj. Xhemaile Deda, listuar me nr. 23 në aneksin 1, për masën e grantit të rindërtimit me vlerë 2,617,558 lekë

Me raportin nr. 13686 datë 21.11.2024, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike në vijim të shkresave të Njësisë Administrative Manëz, kërkesave dhe deklarimeve të subjekteve të prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, ka kryer vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve aplikuese për të kaluar si përfitues nga Programi i grantit për rindërtimin e banesave individuale të dëmtuara tek përfitimi nga Programi i zonave të reja për zhvillim.

Referuar Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” percaktohet ndër të tjera se: “.....Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave.”;

Konkretisht, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ndodhur në dosjen e subjektiveve përfitues znj. Xhemaile Deda, nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, rezulton se;

- Subjekti aplikues Xhemaile Deda është shpallur përfituese në programin e rindërtimit në të njëjtën truall me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.78, datë 10.08.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale në njësitë administrative nr. 1,2,4, Katund i Ri, Sukth, Manëz, Ishëm dhe Rrashbull, Bashkia Durrës, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, listuar në Aneksin 8 me numër rendor 1.
- Në këto kushte, Xhemaile Deda me Deklaratën Noteriale me Nr. repertori: 1864, Nr.koleksioni: 739, datë 17.10.2022 ka kërkuar që fondi i parashikuar për rindërtimin e banesës të kalojë në llogarinë e tij bankare sipas procedurave të parashikuara ligjore dhe ndërtesën e saj ta rindërtojë personalisht me anë të subjekteve private duke respektuar legjislacionin mbi ndërtimet. Nga sa më sipër Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 166, datë 23.12.2021 “Për miratimin e listës së tetë të 25 subjekteve përfituese të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model” ka shpallur përfitues Xhemaile Deda, listuar me nr. 23 në aneksin 1, për masën e grantit të rindërtimit me vlerë 2,617,558 lekë.
- Me shkresën nr. 8988 Prot, datë 25.07.2024 znj. Xhemaile Deda, ka kërkuar që të tranferohet në zonën e re për zhvillim në Manëz për shkak se e ka të pamundur rindërtimin e banesës në të njëjtin truall .

Në këto kushte, bazuar sa më lart, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, ka referuar dhe ka paraqitur dokumentacionin e znj. Xhemaile Deda pranë Komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe për zgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit. Komsioni i posaçëm për vlerësimin dhe për zgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dërguar miratoi ndryshimet e mëposhtme, dhe i kërkon Këshillit Bashkiak:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 166, datë 23.12.2021 "Për miratimin e listës së 8 të 25 subjekteve përfituese të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model", duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese të grantit të rindërtimit të banesave individuale, për shkak të pamundësisë për të rindërtuar në të njëjtin truall të subjektit përfitues Xhemaile Deda me numër rendor 23.
2. Miratimin e subjektit përfitues, znj. Xhemaile Deda, si subjekt përfitues nga programi i zhvillimit të zonave të reja për zhvillim, sipas tabelës së mëposhtme.

NR.	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMER	MBIEMER	PERBERJA FAMILJARE	STRUKTURA	VLERA E GRANTIT	ZONA E TRANSFERIMIT
1	MANEZ	XHEMAILE	DEDA	4	2+1	2,617,558	MANEZ

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONI I POSAÇËM

	Gentian	Kallmi	Kryetar	
Robert Dervishi	Anëtar	Andri	Cerri	Anëtar
Diana Mandia	Anëtare	Klarita	Agasi	Anëtare
Lorenc Facja	Anëtar	Muharrem	Sula	Anëtar